



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / РЕСПУБЛИКА КОСОВО	
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE	
Njësia org. Org. Unit	50-02
Nr. i Faqeve Pr. Stranica No. Pages	- 05 -
Nr. i Prot. Br. i Prot. Prot. No.	2026-2/25
Data: Datum: Date:	29.07.25
PRISHTINË / A	
No. 1	

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	18.07.2025
REFERENC-Ë:	25/2026/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Partner-Therrtore" Sh.p.k. për veprimtarinë: Therrtore, fabrikë për prodhimin dhe përpunimin e mishit, Banullë, Lipjan.
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesës për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "Partner-Therrtore" Sh.p.k. për veprimtarinë: Therrtore, fabrikë për prodhimin dhe përpunimin e mishit, Banullë, Lipjan.

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe vizitës në teren, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 25/1073/MMPHI
Datë: 17.07.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, si dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa me Nr.Prot.25/4175/MMPHI, e operatorit "Partner-Therrtore" Sh.p.k. për t'u pajisur me Leje Mjedisore, për veprimtarinë: Therrtore, fabrikë për prodhimin dhe përpunimin e mishit, Banullë, Lipjan, në ngastrat kadastrale, zona kadastrale Banullë, Lipjan, sipas Korrigjimit të Vendimit të Pëlqimit Mjedisor Nr.: 22/3412-2/ZSP/86/23 të lëshuar me datë: 16.02.2023, ku është bërë korrigjimi gabimit teknik në Vendimin e Pëlqimit Mjedisor me Nr.: 21/3412/1-ZSP/MMPHI, të lëshuar me datë: 22.10.2021, për arsye se është shkruar gabimisht ngastra kadastrale nr.00908-3, zona kadastrale Banullë, Lipjan, duke përfshirë ngastrën kadastrale nr.00908-0, zona kadastrale Banullë, Lipjan.

Operatori obligohet:

- Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
- Të mirëmbahet impianti për trajtimin e ujërave që rrjedhin nga procesi teknologjik i therrjes së kafshëve;
- Mbeturinat nga procesi teknologjik i therrjes së kafshëve të hudhen dhe ruhen në konteiner të veçantë, derisa të merren nga kompania, sipas kontratës për grumbullimin dhe asgjësimin e nënprodukteve shtazore;
- Raportimi në MMPHI, të bëhet sipas kushteve në Leje dhe legjislacionit në fuqi;
- T'i përmbahet kushteve të Lejes Ujore për Shfrytëzim dhe Shkarkim;
- Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor;
- Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kritereve ligjore dhe përshtimit në aplikacion;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI.

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës me Nr.Prot.25/4175/MMPHI për t'u pajisur me Leje Mjedisore, për operatorin "Partner-Therrtore" Sh.p.k. për veprimtarinë: Therrtore, fabrikë për prodhimin dhe përpunimin e mishit, Banullë, Lipjan, në ngastrat kadastrale, zona kadastrale Banullë, Lipjan, sipas Korrigjimit të Vendimit të Pëlqimit Mjedisor Nr.: 22/3412-2/ZSP/86/23 të lëshuar me datë: 16.02.2023, ku është bërë korrigjimi gabimit teknik në Vendimin e Pëlqimit Mjedisor me Nr.: 21/3412/1-ZSP/MMPHI, të lëshuar me datë: 22.10.2021, për arsye se është shkruar gabimisht ngastra kadastrale nr.00908-3, zona kadastrale Banullë, Lipjan, duke përfshirë ngastrën kadastrale nr.00908-0, zona kadastrale Banullë, Lipjan, MMPHI konstaton se operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr. 13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 810711722, datë: 08.04.2015, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.: 21/3412/1-ZSP/MMPHI, datë: 22.10.2021, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;

- Korrigjim i Vendimit të Pëlqimit Mjedisor Nr.: 22/3412-2/ZSP/86/23, datë: 16.02.2023, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Vendim për Dhënien e Certifikatës së Legalizmit, 8Nr.351-75231, datë: 28.04.2022, të lëshuar nga Komuna e Lipjanit;
- Leje Ujore për Shfrytëzim, Nr.: 976/23-ZSP-2023, datë: 17.07.2023, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Leje Ujore për Shkarkim, Nr.: 977/23-ZSP-2023, datë: 17.07.2023, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Kontratë për grumbullimin dhe asgjësimin e nënprodukteve shtazore, datë: 01.01.2025, e lidhur ndërmjet "INCA K" e regjistruar pranë ARBK-së me NUI 811457458 dhe "Partner-Therrtore" Sh.p.k. me NUI 810711722

MMPHI, pas shqyrtimit të kërkesës për pajisje me Leje Mjedisore dhe vizitës në terren të realizuar me datë: 20.06.2025, si dhe pas mbajtjes së takimit me datë: 23.06.2025, ka kërkuar informatat shtesë si në vijim:

- Riplotësim i pikave të aplikacionit që i përkasin menaxhimit të mbeturinave: pikat 8.1.1.; 8.1.2.; 8.1.3.; 8.1.4; 8.1.5. dhe 8.1.6.
- Kontratë me kompaninë për grumbullimin dhe trajtimin e mbetjeve nga procesi teknologjik i therrjes së kafshëve, ku specifikohen mbeturinat sipas Katalogut Shtetëror të Mbeturinave;
- Pagesën e tarifës shtesë, sipas Vendimit Nr.13/99, të dt.30.09.2022

Operatori ka sjellë të gjitha informatat e kërkuara.

Andaj, bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12, dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, merrë vendim që operatorit të lardekur t'i lëshohet Leja Mjedisore.

Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:

- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;
- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;

- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të këtij Udhëzimi Administrativ dhe legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Lipjan;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së